**LIGJ**
**Nr. 48/2020**

# PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË FRANCËS NË LIDHJE ME THEMELIMIN DHE USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË AGJENCISË FRANCEZE TË ZHVILLIMIT, TË *PROPARCO* DHE TË *EXPERTISE FRANCE* NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës në lidhje me themelimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, të *Proparco* dhe të *Expertise France* në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2020
**Shpallur me dekretin nr. 11468, datë 29.4.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

## MARRËVESHJE
## MIDIS KISHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË FRANCËS NË LIDHJE ME THEMELIMIN DHE USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË AGJENCISË FRANCEZE TË ZHVILLIMIT, TË *PROPARCO* DHE TË *EXPERTISE FRANCE* NË SHQIPËRI

Këshilli I Ministrave I Republikës Së Shqipërisë
Dhe
Qeveria E Republikës Së Francës,
Të quajtura në vijim, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "Palët";
Duke kujtuar që Shqipëria dhe Franca udhëhiqen nga dëshira për të forcuar lidhjet e tyre të miqësisë dhe të bashkëpunimit;
Duke shprehur kënaqësinë për vullnetin e tyre të përbashkët për intensifikimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe financiar midis të dyja vendeve;
Duke pranuar që Agjencia Franceze e Zhvillimit (në vijim e quajtur "AFD") dhe filiali i saj i specializuar në financimin e zhvillimit të sektorit privat, Shoqëria e Promovimit dhe e Pjesëmarrjes për Bashkëpunimin Ekonomik (në vijim e quajtur "*Proparco*"), që formojnë grupin ADF (në vijim i quajtur "Grupi AFD"), si dhe Agjencia franceze e ekspertizës teknike

ndërkombëtare, e specializuar në promovimin e asistencës teknike dhe të ekspertizës ndërkombëtare publike franceze jashtë shtetit (në vijim e quajtur "*Expertise France*"), zhvillojnë veprimtaritë e tyre në territorin e Shqipërisë;

Duke kujtuar, nga njëra anë që Grupi AFD është pjesë qendrore e strukturës franceze të ndihmës publike në favor të vendeve në zhvillim dhe që ushtron veprimtaritë e tij në mbi 80 vende, në sajë të një rrjeti prej rreth gjashtëdhjetë përfaqësish vendore;

Dhe, nga ana tjetër, që *Expertise France* është operatori i shtetit francez në fushën e bashkëpunimit teknik ndërkombëtar dhe kontribuon në plotësim të aktivitetit të grupit AFD, për realizimin e objektivave të solidaritetit ndërkombëtar dhe politikën e zhvillimit të Francës;

Duke kujtuar se AFD, si institucion publik, industrial dhe tregtar:

- lufton kundër varfërisë, mbështet rritjen ekonomike dhe merr pjesë në ruajtjen e pasurive publike botërore në vendet në zhvillim, vendet emergjente dhe territoret franceze të përtej-detit;

- e vendosur nën tutelën e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, të Ministrisë së Përtej Detit dhe të Ministrisë së Brendshme, vë në jetë politikën franceze të ndihmës për zhvillim dhe vepron nën kontrollin e këtyre ministrive dhe në bashkëpunim të ngushtë me to;

- ndërhyn kryesisht në kuadrin e programit të investimeve prioritare të shtetit pritës përmes subvencioneve, huave afatgjata dhe garancive të dhëna shtetit, bashkësive vendore dhe ndërmarrjeve e institucioneve financiare publike ose private, ose në kuadrin e pjesëmarrjeve në ndërmarrjet që operojnë në zonat e ndërhyrjes së saj;

- propozon gjithashtu shërbime konsulence, trajnimi dhe asistence teknike;

Duke kujtuar se *Proparco*, e krijuar në vitin 1977 në formën e një shoqërie të së drejtës franceze:

- është një institucion financiar i zhvillimit, i zotëruar në shumicë nga AFD dhe personeli i së cilës i është vënë tërësisht në dispozicion nga AFD;

- ka si mision kryesor të favorizojë investimet private në vendet emergjente dhe në vendet në zhvillim në favor të rritjes, zhvillimit të qëndrueshëm dhe realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ);

- financon operacione ekonomikisht të zbatueshme, shoqërisht të drejta, të qëndrueshme në planin mjedisor dhe financiarisht rentabël;

- investon në një hapësirë gjeografike që shkon nga vendet e mëdha emergjente në vendet më të varfra, me një nivel të lartë kërkesash në fushën e përgjegjësisë sociale dhe mjedisore;

- propozon një gamë të plotë instrumentesh financiare që lejojnë të plotësohen nevojat specifike të investuesve privatë në vendet në zhvillim (hua, kapitale të vetat, instrumente të gati-kapitaleve të veta, garanci dhe inxhinieri financiare);

- ndërhyn vetëm kur asnjë institucion tjetër financiar vendor nuk është në gjendje të propozojë produkte ose shërbime financiare të ngjashme ose kur institucionet financiare vendore kanë nevojë për një ndihmë shtesë për të siguruar një financim;

Duke kujtuar se *Expertise France*, një entitet i sektorit publik i krijuar në vitin 2014;

- mobilizon ekspertizën franceze dhe ndërkombëtare për të mbështetur përcaktimin dhe zbatimin e politikave publike që u përgjigjen sfidave institucionale, ekonomike, demografike, sociale dhe mjedisore;

- ndërhyn për të përforcuar politikat publike të vendeve partnere dhe, në bashkëveprim me vendet përfituese dhe donatorët, në fazat kryesore të ciklit të projektit (identifikim, formulim, zbatim dhe ndjekje) dhe propozon një gamë të gjerë ndërhyrjesh (vënie në dispozicion të një ekspertize afatshkurtër dhe afatgjatë, organizim ateliesh, seminaresh, trajnimesh, vizitash studimore, etj) që mbështeten mbi një qasje të integruar të politikave publike;

- sjell ekspertizën dhe mbështetjen e saj për autoritetet kombëtare për përcaktimin dhe zbatimin e politikave publike në kuadrin e projekteve ndërkombëtare me financime publike franceze, evropiane, të bankave të zhvillimit, të vendeve përfituese ose me financime të fondacioneve private.

Duke kujtuar se është në interesin e përbashkët të Palëve ta nënshkruajnë këtë Marrëveshje për t'i lejuar Grupit AFD dhe *Expertise France* të sjellin asistencën e tyre financiare dhe teknike në Shqipëri, në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë;

Duke kujtuar se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dëshiron t'i japë disa privilegje dhe përjashtime Grupit AFD dhe *Expertise France* për të lehtësuar përmbushjen e misioneve të tyre në kuadrin e politikës në lidhje me financimin e zhvillimit të Shqipërisë;

Duke kujtuar se Shqipëria dhe Franca aderojnë në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961. Për pasojë, në bazë të respektimit të parimeve të pavarësisë, të barazisë sovrane dhe mosndërhyrjes në punët e brendshme, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Francës, kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
**Objekt i marrëveshjes**

1.1. Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar të sjellin një asistencë financiare dhe teknike dhe të investojnë në Shqipëri.

1.2 Kjo Marrëveshje ka si objekt të përcaktojë rregullat e zbatueshme për themelimin dhe ushtrimin e aktiviteteve të Grupit AFD dhe *Expertise France* në Shqipëri. Ajo përcakton kushtet juridike, fiskale dhe financiare të zbatueshme për statusin dhe veprimtaritë e Grupit AFD dhe *Expertise France* në këtë vend.

Neni 2
**Statusi juridik i grupit AFD dhe të *Expertise France***

2.1 Grupi AFD dhe *Expertise France* gëzojnë personalitetin dhe aftësinë juridike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive të tyre në Shqipëri dhe, me këtë cilësi, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe me legjislacionin përkatës shqiptar mund të lidhin kontrata, të blejnë dhe të shesin pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe t'u drejtohen gjykatave.

2.2 Grupi AFD dhe *Expertise France* munden:

a) të ushtrojnë çdo veprimtari të nevojshme për përmbushjen e misioneve të tyre ashtu siç përshkruhen në këtë Marrëveshje;

b) të negociojnë dhe lidhin çdo lloj marrëveshjeje dhe kontrate;

c) të pranojnë çdo lloj garancie ose dorëzanie;

d) të punësojnë personel me shtetësi shqiptare, franceze ose shtetësi të treta.

Neni 3
**Veprimtaritë e grupit AFD dhe të *Expertise France* në Shqipëri**

3.1 Në zbatim të dispozitave të kësaj marrëveshjeje Grupi AFD dhe *Expertise France* munden:

a) t'u japin në Republikën e Shqipërisë ndihmë financiare në euro, në dollarë amerikanë ose në çfarëdolloj tjetër valute dhe çdo formë tjetër asistence financiare ose teknike, si për shembull garanci, enteve, ndërmarrjeve publike ose private dhe institucioneve financiare, si dhe shoqatave ose organizatave publike ose private kombëtare, të huaja ose ndërkombëtare, si dhe çdo personi juridik me seli në Shqipëri;

b) në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar për veprimtarinë e zhvilluar në territorin e Republikës së Shqipërisë të blejnë lirisht çdo lloj pjesëmarrjeje në kapitalin e çdo shoqërie (pavarësisht nga forma e saj) pranë çdo shitësi, të investojnë në fonde investimi dhe t'i transferojnë ose shesin pjesëmarrjen e tyre ose pjesët e saj çdo personi shqiptar ose të huaj;

c) të kryejnë shërbimet e konsulencës, asistencës teknike, trajnimit ose studimeve për entet publike ose private.

3.2 Secila prej veprimtarive të përmendura më sipër është objekt i një kontrate ose një marrëveshjeje specifike që përcakton detyrimet dhe angazhimet e palëve të interesuara nga veprimtaria ose operacioni në fjalë. Çdo Palë zotohet të bëjë gjithçka mundet për të lehtësuar kryerjen e formaliteteve eventuale të kërkuara për të siguruar vlefshmërinë ose hyrjen në fuqi të kontratës në fjalë ose marrëveshjes në fjalë.

3.3 Ushtrimi i veprimtarive të Grupit AFD dhe *Expertise France* nuk kërkon asnjë autorizim ose licencë të karakterit ligjor, nënligjor ose administrativ, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë marrëveshje.

3.4 Marrëveshjet dhe kontratat e lidhura nga AFD me Republikën e Shqipërinë ose çdo ent publik ose privat shqiptar në kuadrin e veprimtarive të tij nënshkruhen në gjuhën frënge dhe në gjuhën shqipe. Vlefshmëria dhe efektet e tyre nuk kërkojnë kryerjen e një përkthimi të autorizuar dhe/ose të noteruar në një gjuhë tjetër.

3.5 Marrëveshjet që lidhen nga AFD me Republikën e Shqipërisë ose çdo entitet publik ose privat shqiptar në kuadrin e asistencës financiare si: hua, grante dhe garanci, rregullohen nga e drejta franceze dhe i nënshtrohen kompetencës së një juridiksioni francez ose të një gjykate arbitrazhi ndërkombëtare të zgjedhur me marrëveshje të përbashkët, ose të çdo organi tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dhe vendimet ose arbitrazhet e shpallura njihen dhe ekzekutohen plotësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

## Neni 4
## **Përjashtimi nga rregullimi bankar**

4.1 Veprimtaritë dhe operacionet e Grupit AFD dhe *Expertise France* konsiderohen si të përgatitura, të vendosura dhe të zbatuara që nga selitë e tyre respektive, të vendosura në Francë.

4.2 Grupi AFD, *Expertise France* dhe Përfaqësia (Përfaqësitë) e tyre, ashtu siç përcaktohet në Nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje, nuk kanë statusin e bankës ose të çfarëdolloj institucioni tjetër financiar në Shqipëri.

## Neni 5
## **Konvertimi dhe transferimet**

5.1 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizon me anë të kësaj Marrëveshjeje:

i) çdo përfitues të një financimi të Grupit AFD ose të *Expertise France* apo çdo garantues të një financimi të tillë;

ii) çdo bankë ndërmjetëse shqiptare ose e huaj e ngarkuar me transferimin e fondeve; si dhe

iii) Grupin AFD dhe *Expertise France*,

të konvertojë në valuta të huaja, me kursin e këmbimit të rënë dakord midis një zyre këmbimi dhe pronarit të fondeve ose të kursit të botuar nga Banka e Shqipërisë në datën e konvertimit, dhe të transferojë lirisht jashtë territorit të Shqipërisë pa kufizime, pa miratim paraprak, çdo shumë që i detyrohet Grupit AFD ose *Expertise France*, konkretisht shumat që u korrespondojnë shlyerjes së financimeve, si në principal ashtu edhe në interesa, kamatë-vonesave, shpenzimeve shtesë, si dhe çdo shumë tjetër që duhet paguar për shkak të ushtrimit ose të kryerjes së veprimtarive të Grupit AFD ose *Expertise France* në Shqipëri.

5.2 Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar gjithashtu të zotërojnë llogari bankare në Shqipëri në çdo valutë, si të konvertojnë në valuta të huaja, me kursin e këmbimit të rënë dakord midis një zyre këmbimi dhe pronarit të fondeve ose të kursit të botuar nga Banka e Shqipërisë në datën e konvertimit, dhe të transferojnë lirisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa kufizime, pa miratim paraprak, çdo shumë që rezulton nga shitja e pjesëmarrjeve ose e pronave të luajtshme ose të paluajtshme, çdo dividend dhe shpërndarje tjetër, çdo fitim, çdo mbivlerë, çdo produkt të realizimit dhe në përgjithësi çdo të ardhur, çdo komision ose çdo kapital të çfarëdolloj natyre qoftë, përfshi gjithashtu dëmshpërblimet dhe interesat që rezultojnë

nga një vendim gjyqësor ose nga një vendim arbitrazhi, kur shuma të tilla vijnë në mënyrë parësore ose të lidhur me çdo investim ose çdo operacion të Grupit AFD ose *Expertise France* në Shqipëri, ose nga realizimi i tyre.

5.3 Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar, sipas rastit, të kryejnë, në ekzekutim të huave ose të çdo operacioni tjetër financiar, këmbimi ose kreditimi, pagesa direkte për furnizuesit ose bashkë-kontraktuesit e huamarrësit ose të përfituesit të interesuar, jo të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur këto përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve që nuk vijnë nga Shqipëria, dhe janë të autorizuar, po të jetë e nevojshme, të përfitojë nga rimbursimi direkt i financimeve të tyre përmes valutave të mbajtura jashtë Shqipërisë.

5.4 Në rast se bankat shqiptare do të refuzojnë të kryejnë ose nuk do të kenë mjaftueshëm valuta të huaja për të kryer një konvertim ose një transferim, ose nëse, për çfarëdolloj arsyeje qoftë, një konvertim ose një transferim nuk kryhet nga bankat shqiptare sepse ato nuk janë të autorizuara të konvertojnë monedhën shqiptare të Grupit AFD dhe *Expertise France,* si dhe të kryejnë transferimin e tyre jashtë shtetit, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (përmes Bankës së Shqipërisë) bën gjithçka është e mundur, në afatet më të mira dhe duke marrë masat e nevojshme, për ta konvertuar monedhën shqiptare në valuta të huaja, me kursin e këmbimit të zbatueshëm të botuar nga Banka e Shqipërisë në datën e konvertimit, dhe kryen transferimin e tyre në llogaritë bankare të huaja të Grupit AFD dhe *Expertise France.*

## Neni 6
## **Statusi fiskal**

6.1 Veprimtaritë e Grupit AFD dhe të *Expertise France*, sipas pikës 1, të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë operacionet, transaksionet, si dhe pasuritë e tyre të paluajtshme, përjashtohen nga tatimet indirekte si TVSH, nga tatimet direkte mbi të ardhurat, taksat lokale, si dhe nga mbajtja e tatimit në burim për interesat dhe dividendët, shpenzimet, komisionet dhe fitimet kapitale.

6.2 Përjashtimet e përmendura në nenin 6.1 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen, konkretisht:

a) për çdo tatim ose detyrim direkt ose indirekt që rezulton nga lidhja ose nga ekzekutimi i marrëveshjeve të kontraktuara ose të nënshkruara në kuadrin e veprimtarive të Grupit AFD dhe të *Expertise France,* sipas pikës 1, të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje;

b) për pagat dhe çdo lloj shpërblimi të paguar nga Grupi AFD ose *Expertise France* punonjësve të tyre që nuk janë shtetas shqiptarë.

6.3 Asnjë ent apo ndërmarrje publike ose private, që i paguan interesa, dividendë, komisione, honorare ose çdo shumë tjetër Grupit AFD ose *Expertise France,* nuk është i detyruar të mbajë tatimin në burim për këto pagesa.

6.4 Grupi AFD dhe Expertise France janë të përjashtuar nga çdo detyrim për deklarim tatimor në lidhje me aktivitetet e zhvilluara në përputhje me pikën 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 7
## **Statusi i përfaqësinht të grupit AFD dhe *Exspertise France* në Republikën e Shqipërisë**

7.1 Përfaqësimi i Grupit AFD dhe *Expertise France* në Shqipëri

a) Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe parashikimet e kësaj marrëveshjeje të hapin një ose disa përfaqësi në territorin e Republikës së Shqipërisë (në vijim e quajtur "Përfaqësia" ose "Përfaqësitë"), me qëllim që të ushtrojnë veprimtaritë e përshkruara në këtë Marrëveshje.

b) Pala shqiptare lehtëson hapjen dhe funksionimin e çdo Përfaqësie në përputhje me këtë Marrëveshje.

c) Përfaqësitë e Grupit AFD ose të *Expertise France* në Shqipëri janë të ngarkuara të identifikojnë projektet që Grupi AFD ose të *Expertise France* mund të realizojnë në Republikën e Shqipërisë, me përgatitjen dhe negocimin e dokumenteve të lidhura me këto projekte, si dhe me ndjekjen e ekzekutimit të tyre.

d) Vetëm selitë qendrore respektive të enteve të Grupit AFD dhe të *Expertise France* në Francë janë të ngarkuara dhe përgjegjëse për: (i) procedurën e shqyrtimit të projekteve, (ii) vlerësimin e tyre, (iii) vendimet e financimit, (iv) derdhjen e fondeve dhe (v) ndjekjen e rimbursimeve.

e) Në përputhje me dispozitat e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje, veprimtaritë e Përfaqësive nuk u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme për bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

f) Grupi AFD dhe *Expertise France* nuk konsiderohen se kanë vendndodhje të përhershme në Republikën e Shqipërisë dhe si rrjedhojë të ardhurat që i korrespondojnë veprimtarive sipas pikës 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje nuk iu atribuohen Përfaqësive të tyre.

g) Grupi AFD dhe *Expertise France* në Republikën e Shqipërisë përfitojnë të gjitha privilegjet dhe imunitetet që u njihen përfaqësive diplomatike në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të 18 prillit 1961.

7.2 Personeli i huaj i Grupit AFD dhe *Expertise France*

a) Grupi AFD dhe *Expertise France* përcaktojnë numrin dhe kualifikimet e anëtarëve të personelit të tyre që nuk kanë shtetësinë shqiptare, apo shtetasve të huaj që nuk kanë rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë (në vijim të quajtur "Punonjësit e huaj") që ata i vlerësojnë të nevojshëm për mirëfunksionimin e Përfaqësisë/Përfaqësive të tyre.

b) Grupi AFD dhe *Expertise France* marrin përsipër koston e plotë të pagave, kompensimeve dhe transportit të Punonjësve të huaj. Këta punonjës përftojnë nga regjimet e sigurimeve shoqërore dhe të pensioneve franceze dhe nuk u nënshtrohen, pra, dispozitave përkatëse që mund të zbatohen në Republikën e Shqipërisë.

c) Pala shqiptare u njeh Punonjësve të huaj të Përfaqësisë imunitetin e juridiksionit për veprimet e kryera gjatë ushtrimit zyrtar të funksioneve të tyre.

d) Pala shqiptare u njeh punonjësve të huaj dhe anëtarëve të familjeve të tyre:

- të drejtën e pajisjes me vizë afatgjatë me disa hyrje-dalje me qëllim pajisjen me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- të drejtën për t'u përjashtuar nga tatimet mbi të ardhurat ose nga çdo tatim i ngjashëm që lidhet me pagat, shpërblimet dhe alokacionet që u paguhen për shkak të veprimtarisë së tyre për Grupin AFD dhe *Expertise France* në Shqipëri;

- lëshimin për bashkëshortin ose partnerin e Punonjësit të huaj të një leje pune të vlefshme për të njëjtën periudhë me vizën ose lejen e hyrjes të Punonjësit të huaj në fjalë, që i lejon bashkëshortit ose partnerit të punojë në Republikën e Shqipërisë;

- të drejtën të importojnë pa taksa objektet dhe sendet e tyre personale në momentin e marrjes së funksionit të parë në Shqipëri;

- lëshimin e çdo autorizimi të nevojshëm për transportimin e lirë të sendeve personale drejt Shqipërisë dhe nga Shqipëria jashtë saj.

7.3 Personeli lokal i Grupit AFD dhe i *Expertise France* në Shqipëri

a) Në kuadrin e veprimtarive të tyre në Shqipëri Grupi AFD dhe *Expertise France* mund të punësojnë punonjës me shtetësi shqiptare ose që banojnë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjet dhe rregullat shqiptare në fushën e të drejtës së punës, sistemit tatimor dhe sigurimeve shoqërore.

b) Këta punonjës gëzojnë imunitet nga juridiksioni vetëm për veprimet e kryera në ushtrim të funksioneve të tyre zyrtare.

7.4 Misionet e përkohshme në Shqipëri

a) Për të kryer me sukses veprimtaritë e tyre në Shqipëri, Grupi AFD dhe *Expertise France* mund të dërgojnë misione të përkohshme në Shqipëri ose të mandatojnë konsulentë për të mbledhur të dhënat e nevojshme për përgatitjen dhe/ose ekzekutimin e projekteve.

b) Pala shqiptare në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar merr masat e nevojshme që anëtarët e misioneve të përkohshme të marrin në afat të shkurtër autorizimet e nevojshme për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë.

c) Për sa i përket rregullave në fushën e migracionit, anëtarët e misioneve të përkohshme përfitojnë nga rregullat e brendshme në fuqi të zbatueshme për personelin në mision të institucioneve financiare ndërkombëtare të zhvillimit që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Pala shqiptare iu njeh anëtarëve të misionit të përkohshëm në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tyre zyrtare:

a) Imunitet nga juridiksioni vetëm për veprimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë në ushtrim të funksioneve të tyre zyrtare;

b) Paprekshmërinë e dokumenteve të tyre zyrtare.

Imunitetet e parashikuara në pikat a dhe b të këtij paragrafi nuk i përjashtojnë anëtarët e misionit të përkohshëm nga juridiksioni i palës franceze.

Neni 8
**Zbatimi i marrëveshjes**

8.1. Me qëllim që të lehtësojë përpjekjet e Grupit AFD dhe të *Expertise France* për zbatimin e veprimtarive të tyre, pala shqiptare u transmeton institucioneve të saj të gjitha informacionet e nevojshme për të lejuar ekzekutimin e plotë të kësaj Marrëveshjeje në afatet më të mira dhe merr të gjitha masat e brendshme për këtë qëllim.

8.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar t'ia paraqesin këtë Marrëveshje, qoftë si referencë, qoftë përmes një kopjeje, çdo autoriteti, çdo nëpunësi dhe në përgjithësi, çdo institucioni publik të Republikës së Shqipërisë. Për t'iu lejuar përfituesve të financimeve të Grupit AFD ose të *Expertise France,* ose bashkë-kontraktuesve të AFD ose të *Expertise France,* të kërkojnë zbatimin e të drejtave të përmendura në këtë Marrëveshje, Grupi AFD dhe *Expertise France* janë të autorizuar t'iu komunikojë një kopje të kësaj Marrëveshjeje këtyre përfituesve ose bashkë-kontraktuesve, me qëllim që ata të mund t'ia paraqesin autoriteteve të interesuara.

8.3 Asnjë dispozitë ligjore, nënligjore ose dispozitë tjetër që bëhet efektive pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të cenojë të drejtat dhe privilegjet e Grupit AFD ose *Expertise France* të parashikuara nga kjo Marrëveshje.

Neni 9
**Hyrja në fuqi**

9.1 Secila prej Palëve njofton Palën tjetër me shkrim për plotësimin e procedurave kushtetuese të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, që merr efekt një muaj pas datës së marrjes së njoftimit të fundit.

9.2 Menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, pala shqiptare, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kryen regjistrimin e kësaj Marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara. Qeveria e Republikës së Francës do të informohet për këtë regjistrim përmes transmetimit të numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, menjëherë pas marrjes së konfirmimit nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

9.3 Kjo Marrëveshje zbatohet për marrëveshjet dhe kontratat që lidhin Grupi AFD ose *Expertise France* në Shqipëri.

Neni 10
**Ndryshimet**

Palët munden, në çdo moment dhe me marrëveshje të përbashkët, të ndryshojnë me shkrim këtë Marrëveshje. Çdo ndryshim bëhet efektiv pas përmbushjes nga secila prej Palëve të procedurave të brendshme përkatëse dhe bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshje.

Neni 11
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje midis Palëve që rrjedh nga interpretimi ose nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhet miqësisht nëpërmjet negocimit mes palëve në rrugë diplomatike.

Neni 12
**Kohëzgjatja dhe denoncimi**

12.1 Kjo Marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të papërcaktuar por afati i saj do të mbarojë në datën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

12.2 Ajo mund të denoncohet në çdo moment nga secila prej Palëve. Denoncimi hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit në rrugë diplomatike. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje nuk prek kontratat ose marrëveshjet në vazhdim të lidhura gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

Bërë në Bruksel, më 17 shkurt 2020, në dy (2) kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe frënge, ku të dyja tekstet kanë vlerë të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË QIPËRISË
**Edi Rama**
Kryeministër
dhe
Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË FRANCËS
**Jean-Yves Le Drian**
Ministër i
Evropës dhe i Punëve të Jashtme